



INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT në KOSOVË

RAPORTI SPECIAL NR. 4

mbi

**Aspektet e caktuara të
Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2001/18
mbi krijimin e Komisionit për shqyrtimin e paraburgimit për
paraburgimet jashtëgjyqësore të bazuara mbi Urdhëresat Ekzekutive
(25 gusht2001)**

adresuar

**Z. Hans Haekkerup
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara**

Ombudspersoni për Kosovë, në pajtim me nenin 4.3 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi krijimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe të Rregullës 22, par. 3 dhe 4 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit, më 12 shtator 2001

i ka prezantuar raportin në vijim z. Hans Haekkerup, Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, sipas këtyre dispozitave:

PRAPAVIJA

1. Ky Raport Special mbështetet pjesërisht në kërkesat e parashtruara lidhur me Raportin Special Nr. 3 mbi pajtueshmërinë e privimit të lirisë sipas "Urdhëresave Ekzekutive" me standardet e njohura ndërkombëtare, adresuar z. Hans Haekkerup, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (29 qershor 2001)(më tutje Raporti Special Nr.3) dhe të përsëritur në të tre Raportet e datës së sotme, gjetje të shkeljeve të caktuara të të drejtave të njeriut në rastet e z. Çelë Gashi, z. Avdi Behluli dhe të z. Jusuf Veliu

2. Në Raportin Special Nr. 3 dhe në bazë të autorizimeve të dhëna sipas nenit 4 të Rregullorës së UNMIK-ut 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, Ombudspersoni i ka bërë disa rekomandime Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (më tutje PSSP). Deri më sot, Ombudspersoni nuk ka marrë asnjë përgjegjje zyrtare për asnjë nga rekomandimet e bëra.

3. Më 25 gusht 2001, PSSP-ja nxorri rregullorën e UNMIK-ut 2001/18 mbi krijimin e Komisionit për shqyrtimin e paraburgimit për paraburgimet jashtëgjyqësore në bazë të Urdhëresave Ekzekutive (më tutje rregullorja e UNMIK-ut 2001/18). Disa aspekte të kësaj Rregullore në mënyrë të qartë synojnë që t'i adresojnë qështjet e reflekuara në një nga rekomandimet që Ombudspersoni i kishte paraqitur në Raportin Special Nr.3.

HEQJA DORË

4. Asgjë nga përmbajtja e këtij Raporti nuk duhet nënkuptuar si heqje dorë të Ombudspersonit nga e drejta e tij për të hetuar ankesat e individëve që pohojnë shkeljet e të drejtave të njeriut apo keqpërdorimet e autoritetit lidhur me privimin e lirisë të ngarkuar me Urdhëresat Ekzekutive ose të shkaktuar nëpërmjet akteve tjera administrative.

Ombudspersoni poashtu i mban të gjitha të drejtat që të ushtrojë jurisdiksionin e tij sipas nenit 4.3 të Rregullorës së UNMIK-ut 2000/38 për të shqyrtuar pajtueshmërinë e Rregulloreve të UNMIK-ut ose instrumenteve të ngjajshme me standardet e njohura ndërkombëtare, lidhur me çështjet e paraqitura në këtë Raport.

QËLLIMI I RAPORTIT

5. Ky Raport Special shqyrton pajtueshmërinë e Rregullorës së UNMIK-ut 2001/18 mbi krijimin e Komisionit për shqyrtimin e paraburgimit për paraburgimet jashtëgjyqësore në bazë të Urdhëresave Ekzekutive (25 gusht)(më tutje Rregullorja e UNMIK-ut 2001/18 ose Rregullorja) me standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në veçanti atyre të themeluara nën par. 4 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

INSTRUMENTET RELEVANTE NDËRKOMBËTARE

6. Neni 11 i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuar (1999) (10 qershor 1999) (prej këtu Resoluta 1244) në pjesën përkatëse thotë:

Këshilli i Sigurimit... vendos që përgjegjësia kryesore e prezencës ndërkombëtare civile do të përfshijë... (j) mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut....

7. Neni 1 i Regullorës së UNMIK-ut Nr. 1999/1 mbi autoritetin e Administratës së Përkohëshme Civile në Kosovë (25 korrik 1999)(më tutje Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/1) në pjesën përkatëse thotë:

1. I gjithë autoriteti legjislativ dhe ekzekutiv në Kosovë, përfshirë edhe administratën e judikaturës, i ngarkohet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

8. Neni 1 i Regullorës së UNMIK-ut Nr.1999/24 mbi ligjin e Aplikueshëm në Kosovë (12 dhjetorë 1999)e ndryshuar me Rregullorën e UNMIK-ut Nr. 2000/59 (27 tetor 2000) (prej këtu Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59) në pjesën përkatëse thotë:

1.1 Ligji në fuqi në Kosovë përfshin:

a. Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe

b. Ligjin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

1.3 Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjithë personat me detyra publike ose që mbajnë pozita publike duhet t'i respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut veçanërisht në [...] Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të 4 nëntorit 1950....

9. Rregullorja e UNMIK-ut 2001/18 mbi themelimin e Komisionit për shqyrtimin e paraburgimeve jashtëgjyqësore të bazuara në Urdhëresa Ekzekutive (25 gusht 2001)(prej këtu Rregullorja 2001/18) në pjesën përkatëse thotë:

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm...

Duke marrë parasysh parimet e përcaktuara në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politikedhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut,

Duke vlerësuar nevojën për ekzistimin e një mekanizmi për shqyrtimin juridik të paraburgimit, duke përfshirë edhe paraburgimin jashtëgjyqësor,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

Neni 1: Formimi i Komisionit për shqyrtimin e paraburgimit

Komisioni për shqyrtimin e paraburgimit (“Komisioni”) formohet me qëllim të shqyrtimit të paraburgimeve jashtëgjyqësore në bazë të urdhërit ekzekutiv.

Neni 2: Përmbajtja e Komisionit për shqyrtimin e paraburgimit

2.1 Komisioni do të përbëhet nga tre anëtarë ndërkombëtarë, të cilët i emëron Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Së paku dy prej tyre do të jenë gjyqëtarë në shtetet e tyre përkatëse...

Neni 4: Procedurat e Komisionit për shqyrëtimin e paraburgimit

4.1 Komisioni shqyrton rastet e paraburgimeve jashtëgjyqësore të bazuara në urdhëra ekzekutiv. Shqyrtimi mund të inicohet me propozimin e vetë Komisionit ose me kërkesën e personit të paraburgosur në bazë të një urdhëri të tillë ekzekutiv ose me kërkesën e mbrojtësit të tij apo saj.

4.2 Me rastin e shqyrtimit të një paraburgimi të tillë jashtëgjyqësor, Komisioni konvokon një seancë në mënyrë që i paraburgosuri apo mbrojtësi i tij dhe personat përgjegjës duke përfshirë prokurorin publik, gjyqëtarin hetues ose organet përkatëse policore të mund të dëgjohen.

4.3 Procedura gjyqësore e Komisionit duhet të jetë në pajtim me këtë rregullore dhe rregullat e tilla procedurale që mund t'i miratoj Komisioni...

Neni 5: Masat e posaçme për provat, informatat dhe materialet tjera delikate

5.1 Komisioni urdhëron masa të posaqme për provat, informatat dhe materialet tjera delikate nëse zbulimi i tyre personit të paraburgosur ose mbrojtësit të tij apo të saj mund të rrezikoj sigurinë e hetimeve, operacionet ushtarake apo jetën dhe sigurinë e personit të dëmtuar, dëshmitarit, personit që ka dhënë informata apo anëtarëve të familjeve të tyre.

5.2 Aty ku është e mundur, Komisioni i rezimon provat, informatat a materialet tjera delikate, në mënyrë që të mos rrezikojë sigurinë e hetimeve, operacionet ushtarake apo jetën dhe sigurinë e personit të dëmtuar, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre dhe një rezime të tillë ia ofron personit të paraburgosur apo mbrojtësit të tij apo të saj.

5.3 Në qoftë se provat, informatat ose materialet tjera delikate nuk mund të ofrohen në formë të përmbledhur, pa rrezikuar sigurinë e hetimeve, operacionet ushtarake, jetën dhe sigurinë e palës së dëmtuar, të dëshmitarit, të informatorit ose të anëtarëve të familjes së tyre, Komisioni urdhëron që këto prova, informata ose materiale tjera delikate të mos i jepen personit të paraburgosur dhe mbrojtësve të tij dhe i shqyrton ato me me dyer të mbyllura. Në këtë rast Komisioni e emëron një Këshill të posaçëm për të përfaqësuar interesat e personit të paraburgosur në shqyrtimin që mbahet me dyer të mbyllura. Këshilli i posaçëm nuk komunikon me personin e paraburgosur e as me mbrojtësit e tij për asnjë çështje që ka të bëjë

me provat, informatat ose materialet tjera delikate, përveç se të kërkojë informata specifike nga personi i paraburgosur ose mbrojtësit e tij, në pajtim me rregullat e procedurës gjyqësore.

Neni 6: Vendimi i Komisionit për shqyrtimin e paraburgimit

6.1 Komisioni mund të vendosë se një person paraburgim jashtëgjyqësor i bazuar në një urdhër ekzekutiv është i arsyeshëm në raste kur komisioni konsideron se ka baza të arsyeshme të dyshohet se një person ka kryer një veprë penale dhe

a. identiteti i tij nuk mund të verifikohet ose nëse ekzistojnë rrethana të tjera që sugjerojnë mundësi të madhe të ikjes, ose

b. ka baza të arsyeshme për dyshim se ai mund t'i shkatërrojë gjurmët e veprës penale ose rrethanat e posaçme tregojnë se ai do t'i pengojë hetimet, duke ndikuar në dëshmitarët, bashkëpjesëmarrësit ose personat që janë duke fshehur veprën penale ose gjurmët e asaj veprë, ose

c. rrethanat e posaçme arsyetojnë frikën se vepra penale do të përsëritet ose ekziston tentimi për përfundimin e veprës penale ose një veprë penale mund të kryhet nën kërcënim.

6.2 Nëse Komisioni vendos se një paraburgim jashtëgjyqësor në bazë të urdhërit ekzekutiv nuk është i arsyeshëm, atëherë urdhëri ekzekutiv shfuqizohet dhe personi i paraburgosur lirohet menjëherë.

6.3 Nëse Komisioni vendos se paraburgimim jashtëgjyqësor në bazë të urdhërit ekzekutiv është i arsyeshëm, atëherë vendimi i Komisionit trajtohet si vendim i një trupi gjykues të Gjykatës Supreme që urdhëron paraburgimin sipas kuptimit të nenit 197(2) të Ligjit mbi Procedurën Penale në fuqi. Në një rast të tillë, vendimi i Komisionit saktëson kohëzgjatjen e paraburgimit , mbrenda kufijve të nenit 197(2).

Neni 7: Mbyllja e vendimeve të Komisionit mbi shqyrtimin e paraburgimit

Vendimet e Komisionit lidhur me masat e posaçme për provat, informatat dhe materialet tjera delikate, të parashtruara në nenin 4, ose lidhur me paraburgimin jashtëgjyqësor të bazuar në një urdhër ekzekutiv, siç është përcaktuar në nenin 5, nuk mund të apelojnë.

Neni 8: Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerr urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj rregullore.

Neni 9: Ligji në fuqi

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë ligjore të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 10: Hyrja në fuqi

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi me 25 gusht 2001 dhe do të qëndroj në fuqi për tre muaj.

10. Neni 5 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore për të Drejtat e Njeriut (4 nëntor 1950) (më tutje Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose Konventa) thotë si vijon :

1. Çdo njeri ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me rregjet ligjore:

- (a) kur burgoset rregullisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;
- (b) kur arrestohet ose burgoset në mënyrë të rregullt për moszbatim të një urdhëri të dhënë, në përputhje me ligjin, nga një gjykatë, ose për të siguruar zbatimin e një detyrimi të parashikuar me ligj;
- (c) kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'a çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale, ose kur ka motive të arsyeshme për të menduar se duhet ndaluar të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;
- (d) kur është fjala për heqjen e rregullt të lirisë së një të mituri kur kjo vendoset për edukimin e tij të mbikqyrur, ose për heqjen e rregullt të lirisë së tij me qëllim për ta çuar përpara autoritetit kompetent;
- (e) kur është fjala për heqjen e rregullt të lirisë së një personi të dyshuar se mund të përhapë një sëmundje ngjitëse, të një të çmenduri, të një alkooliku, të një toksimani ose të një vagabondi;
- (f) kur është fjala për arrestimin ose burgimin e rregullt të një personi për të mos e lejuar të hyjë në mënyrë të paligjshme në territor, ose kundër të cilit është në vijim një procedurë dëbimi ose ekstradimi;

3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur, në kushtet e parashikuara në paragrafin 1.c. të këtij neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatësi, ose një magjistrati të autorizuar me ligj që të ushtrojë funksione gjyqësore, dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet gjatë procedurës. Lirimi mund të kushtëzohet me një garanci që siguron paraqitjen e personit të interesuar përpara gjyqit;

4. Çdo person të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të paraqesë një ankim përpara një gjykate me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit dhe të urdhërojë lirimin, nëse burgimi është i paligjshëm

PRAPAVIJA E ANALIZËS

11. Në Raportin Special Nr.3, Ombudspersoni ka gjetur, *inter alia*, se çdo privim i lirisë së individit i vendosur në bazë të Urdhëresave Ekzekutive të Përfaqësuesit Special Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) nuk mund të konsiderohet i ligjshëm sipas kuptimit të par. 1 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe se mungesa e kontrollit mbi privimin e lirisë të vendosur me Urdhëresa Ekzekutive të lëshuara nga PSSP përbënë shkelje të par. 3 dhe 4 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni ka konkluduar se privimi i lirisë i vendosur sipas Urdhëresave Ekzekutive nuk është në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtare.

12. Siç është cekur më lart (shih par. 2), deri më sot shkeljet e të drejtave të njeriut të identifikuar nga ana e Ombudspersonit në Raportin Special Nr. 3 nuk janë zgjidhur. Ai po lëshon Raportin Special Nr. 4 me qëllim që të qartësojë çështjet e paraqitura në Raportin e mëparshëm duke marrë parasysh synimin dhe qëllimin e Rregullorës së UNMIK-ut 2000/18 për të adresuar një numër të kufizuar të qështjeve të ngritura në Raportin Special Nr. 3.

13. Ombudspersoni përkujton se privimi i lirisë i vendosur me "Urdhëresa Ekzekutive" në mënyrë të qenësishme është i paligjshëm në kuptim të par. 1 të nenit 5 (Raporti Special Nr.3. par. 9-16). Ombudspersoni vëren se argumenti i Rregullorës së UNMIK-ut 2001/18 është se nuk kërkohen baza ligjore për këto privime të lirisë. Ombudspersoni konsideron se kjo mangësi themelore e Rregullores – dështimi për ta adresuar paligjshmërinë e privimeve të tilla të lirisë – paraqet bazën kryesore për debatin vijues. Megjithatë, ai gjithashtu konsideron se një argument tjetër i kësaj Rregullore – se institucioni me mbrojtje të kufizuar procedurale mjafton për të sjellur ligjin dhe praktikën e privimit të lirisë me Urdhëresa Ekzekutive në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtare - kërkon ekzaminim të mëtutjeshëm.

Nëse Komisioni për shqyrtimin e paraburgimit sipas Rregullorës së UNMIK-ut 2001/18 mund të konsiderohet si gjykatë në kuptim të paragrafit 4 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

14. Duket se Rregullorja e UNMIK-ut 2001/18 ka për qëllim që të garantojë të drejtat e mbrojtura me paragrafin 4 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili thotë:

Çdo njeri të cilit i është privuar liria me anë të arrestimit ose të paraburgimit ka të drejtë të ndërmarrë procedura me anë të të cilave do të vendoset me shpejtësi nga një gjykatë ligjshmëria e ndalimit të tij ose lirimi i tij nëse paraburgimi nuk është i ligjshëm.

Ombudspersoni përkujton se par. 4 i nenit 5 të Konventës kërkon garantimin institucional dhe procedural për të arritur qëllimet e nenit 5 si tërësi (shih Raportin Special Nr.3, par.17-21)

15. Lidhur me aspektet institucionale të garantimit të siguruar me par. 4 të nenit 5, Ombudspersoni përkujton të drejtën lëndore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që themelon karakteristikat e një 'gjykate' në pajtim me kërkesat e Konventës. Ombudspersoni më tutje përkujton se e drejta lëndore konstante e Gjykatës thekson rëndësinë e pavarësisë, veçanërisht nga ekzekutivi, si një nga parimet themelore të një 'gjykate' (shih, p.sh. aktgjykimin në rastin *Belilos kundër Zvicrrës*, më 29 prill 1988). Ky nocion i pavarësisë poashtu është në pajtim me parimet demokratike në ndarjen e fuqisë, në veçanti me respektimin e sundimit të së drejtës. Ombudspersoni poashtu përkujton që respektimi i sundimit të së drejtës kërkon që ekzekutivi të mos jetë mbi ligjin. Siç ka vërejtur ai edhe më parë, ngarkimi i autoritetit ekzekutiv dhe legjislativ një personi, siç është bërë me Rregullorën e UNMIK-ut 1999/1, në mënyrë të qenësishme është në mospajtim me sundimin e së drejtës dhe prandaj edhe me standardet e njohura ndërkombëtare (shih Raportin Special Nr. 1 par. 24). Ombudspersoni në fund përkujton se një 'gjykatë' sipas termeve të Konventës duhet të ketë jurisdiksion që të caktojë të gjitha aspektet e rastit pranë saj, me fjalë tjera qështjet lidhur me faktet ashtu edhe me ligjin, dhe të lëshojë vendime të obligueshme që nuk mund të ndryshohen nga autoritetet jogjyqësore (aktgjykimi në rastin *Van de Hurk kundër. Holandës*, më 19 prill 1994).

16. Ombudsperson vëren se neni 2.1 i Rregullorës së UNMIK-ut 2001/18 thotë:

Komisioni për Shqyrtimin e Paraburgimit duhet të përbëhet nga tre anëtarë ndërkombëtar të emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Neni 1 i Rregullorës thotë:

Komisioni për Shqyrtimin e Paraburgimit ('Komisioni') është themeluar me qëllim të shqyrtimit të paraburgimeve jashtëgjyqësore të bazuara në urdhëresat ekzekutive.

17. Ombudspersoni vëren se dispozitat e lartpërmendura të Rregullorës së UNMIK-ut 2001/18 e qartësojnë se PSSP, duke vepruar në kapacitetin e tij si ligjvënës në Kosovë ka nxjerrë një ligj që i garanton PSSP, duke vepëuar si ekzekutiv në Kosovë, kontrollin mbi një proces gjyqësor me rëndësi themelore. Ombudspersoni poashtu vëren se Komisioni për shqyrtimin e paraburgimit i thirrur me Rregullorën e UNMIK-ut 2001/18 do të ketë jurisdiksion vetëm të shqyrtojë një akt që në esencë është në kundërshtim me ligjin, për arsytet e përshkruara diku tjetër, edhe për shkak të faktit se secili akt i tillë është kryer në kundërshtim me ushtrimin e jurisdiksionit të një gjykate kompetente dhe të themeluar në mënyrë të rregullt. Me këtë rast, Rregullorja zëvendëson një 'Komision', nën kontrollin e ekzekutivit akti i të cilit po kontestohet, me një 'gjykatë', pavarësia, paanësia dhe jursdiksioni i plotë i së cilës kurrë nuk është venë në pyetje. Siç është cekur diku tjetër, baza e vetme për shkeljen e vendimit të një gjykate kompetente është se ekzekutivi nuk është pajtuar me vendimin e gjykatës (Reporti Special Nr. 3 dhe Raportet e 12 shtator 2001 në rastet e Çelë Gashit, Avdi Behlulit dhe Jusuf Veliut). Këta faktorë, marrë ndaras ose së bashku, shërbejnë për të prishur pavarësinë e gjyqësisë lidhur me ushtrimin e jurisdiksionit mbi privimet e lirisë, në kundërshtim jo vetëm me dispozitat e aplikueshme të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe me parimet demokratike që përbëjnë Konventën në tërësi.

Konkludimi

18. Ombudspersoni konkludon se, organi i paraparë sipas Rregullorës së UNMIK-ut 2001/18 mbi themelimin e Komisionit për shqyrtimin e paraburgimit jashtëgjqësor të bazuar në Urdhëresat Ekzekutive, nuk mund të konsiderohet si gjykatë në kuptimin e par. 4 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Nëse procedurat e kërkuara në Rregullorën e UNMIK-ut 2001/18 janë në pajtim me kërkesat e par. 4 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

19. Përveç kërkesave të par. 4 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që individi i cili ka qenë i privuar nga lirija e tij ose e saj ka të drejtë të ketë ligjshmërinë e atij privimi të lirisë të caktuar me gjyq, Ombudspersoni vëren se procedurat duhet të ketë karakter gjyqësor. Në përgjithësi, këto kërkesa procedurale paraqesin parimet e të drejtave të barabarta të palëve që nënkupton të gjitha procedurat gjyqësore të udhëhequra sipas Konventës .

20. Ombudspersoni përkujton se zbatimi i parimit të barazisë së palëve nuk bie ekskluzivisht në duart e palëve, por vetë gjykata ka një obligim pozitiv që t'i zbatojë parimet (shih p.sh. aktgjykimin në rastin *Botten kundër Norvegjisë*, më 19 shkurt 1996). Ombudspersoni më tutje përkujton se e drejta lëndore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut themelon rregullën se një të paraburgosuri dhe/ose avokatit të tij/saj duhet të i sigurohen informata të mjaftueshme relevante për përcaktimin e privimit të lirisë që të jenë në gjendje të kundërshtojnë vendimin për paraburgim (aktgjykimin në rastin *Lietzow kundër Gjermanisë* më 13 shkurt 2001). Ombudspersoni poashtu përkujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka refuzuar argumentet qeveritare se rreziku i pohuar i marrëveshjes së fshehtë ndërmjet avokatit mbrojtës dhe të akuzuarit mund të arsyetojë kufizimin e qasjes mes tyre apo monitorimin e komunikimeve të tyre, një parim që aplikohet në veprimet e tjera qeveritare duke ndikuar negativisht në udhëheqjen e mbrojtjes ose çështjeve anësore si vendimi i paraburgimit (aktgjykimin në rastin *S kundër Zvicrrës*, më 28 nëntor 1991).

21. Procedurat e parashikuara me Rregullorën e UNMIK-ut 2001/18 mund të përshkruhen si vijon:

a) Para mundësisë së shqyrtimit nga ana e Komisionit për shqyrtimin e paraburgimit, këto ngjarje të poshtëshënuara duhet të pasojnë:

- Individi do të ishte arrestuar dhe paraburgosur për një periudhë të shkurtë kohore të lejuar sipas dispozitave relevante të Kodit të Procedura Penale (24 deri 72 orë);
- Poashtu në pajtim me dispozitat relevante të Kodit të Procedurës Penale, individi do të ishte sjellur para gjykatës kompetente, gjykata e cila do të kishte shqyrtuar çfarëdo kërkesë nga ana e ekzekutivit përgjegjës për të paraburgosur individin duke pasë parasysh faktet dhe ligjin, dhe që do të kishte vendosur mbi lirimin e individit;
- PSSP do të kishte lëshuar një Urdhëresë Ekzekutive për të autorizuar vazhdimin e paraburgimit të individit, duke shfuqizuar me këtë rast vendimin e gjykatës kompetente.

b) Shqyrtimi nga ana e Komisionit për shqyrtimin e paraburgimit nxitet me kërkesën e të paraburgosurit apo avokatit të tij/saj apo do të bëhet nga Komisioni mbi bazat *ex officio* dhe duhet të udhëhiqet mbrenda kornizës vijuese:

- Komisioni do të thirrë një dëgjim në të cilën një numër i madh i personave, deklaratat e të cilëve tashmë janë dëgjuar nga gjykata kompetente, do të dëgjohen përsëri, së bashku me personat tjerë.
- PSSP-së do t'i lejohet paraqitja e informacioneve të mbajtura fshehtë para gjykatës kompetente të instancës së parë, të paraburgosurit dhe avokatit mbrojtës të paraburgosurit, apo të siguruara dy palëve të fundit nën diskrecion dhe nën kontroll të ekzekutivit vetëm në lidhje me shqyrtimin e Komisionit;
- Komisioni do të deklarohet mbi urdheresën ekzekutive për të paraburgosur individin në fjalë mbi të njejtat baza të shqyrtuara nga gjykata kompetente e instancës së parë, dhe të cilat ishin gjetur të jenë të pabazuara nga ajo gjykatë e instancës së parë.

22. Ombudspersoni vëren se fusha e shqyrtimit të paraburgimit jashtë gjyqësore të bazuar në një urdheresë ekzekutive sipas nenit 6.1 të Rregullorës së UNMIK-ut 2001/18 përputhet në një shkallë të lartë me fushën e shqyrtimit tashmë të ngarkuar mbi gjykatat e rregullta që ushtrojnë kontroll gjyqësor mbi privimet e lirisë që bijnë mbrenda fushës së par. 3 dhe 4 të nenit 5. Ombudspersoni vëren se nuk duket të egzistojë ndonjë arsyetim për perjashtimin apo shkeljen e vendimeve të marra nga gjykatat e rregullta, sipas Rregullorës së UNMIK-ut 2001/18. Në veçanti, Ombudspersoni ka theksuar se është funksion normal i gjykatave vendore për të shqyrtuar të gjitha faktet dhe dëshmitë lidhur me çeshtje të veçanta mbi të cilat gjykata ushtron juridiksion. Është gjithashtu normale për gjykatën që t'i shqyrtojë informatat e ndieshme dhe konfidenciale në këtë kontekst dhe të respektojë normat etike profesionale lidhur me ruajtjen e konfidencialitetit të informatave që bijnë në fushën e proceseve të saj të shqyrtimit. Nuk duket të ketë ndonjë dëshmi që gjykatat kompetente, e në veçanti, kolegjet ndërkombëtare të gjykatësve që përbëjnë gjykatat kompetente që marrin vendime inicuese lidhur me paraburgim, kanë vepruar në mënyrë jo të duhur lidhur me vendimet për të paraburgosur apo liruar dikë në Kosovë. As nuk duket të ketë ndonjë bazë legjitime për të pretenduar se ata do të vepronin në mënyrë joprofesionale dhe jo të duhur lidhur me shqyrtimin e informatave të ndieshme lidhur me vendimin për të paraburgosur një individ sipas cilësdo bazë të cekur në par. 1 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

23. Ombudspersoni vëren se neni 5 i Rregullorës së UNMIK-ut 2001/18 është bazuar mbi të njejtin pretendim negativ lidhur me të paraburgosurin dhe avokatin e tij siç është bërë për gjykatat në tërë Rregullorën. Lidhur me këtë, Ombudspersoni më tutje vëren se vendosja e praktikave si përmbledhja apo fshehja e informatave relevante nga individ, të drejtat themelore për liri të të cilit janë në pyetje, kundërshton të drejtën lëndore të themeluar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih par. 20, *supra*). Ombudspersoni gjithashtu vëren se emërimi i 'Këshillit Special', roli i të cilit është të paraqesë interesat e personave të paraburgosur, por të cilit i është ndaluar të komunikojë dëshmitë, informacionet apo materialet e tjera të ndieshme, përveç të kërkojë informata specifike nga i paraburgosuri apo

avokati i tij/saj mbrojtës' nuk mund të konsiderohet si garantim i barazisë së palëve që formon bazën e çdo procedure lidhur me privimet e lirisë.

Konkludim

24. Ombudspersoni konkludon, që procedura e paraparë sipas Rregullorës së UNMIK-ut 2001/18 mbi krijimin e komisionit për shqyrtimin e paraburgimeve jashtëgjyqësore të bazuara në urdhëresat ekzekutive nuk përmbush kërkesat e paragrafit 4 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

PËRSËRITJA E KONKLUDIMEVE

25. Ombudsperson përserit konkludimet të cekura në Raportin Special nr. 3:

- se çdo privim i lirisë i vendosur me Urdhëresë Ekzekutive nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombëve të Bashkuara nuk mund të konsiderohet si i ligjshëm në kuptim të paragrafit 1 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- se mungesa e kontrollit gjyqësor mbi privimin e lirisë të vendosur sipas Urdhëresave ekzekutive lëshuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombëve të Bashkuara përbën shkelje të paragrafit 3 dhe 4 të nenit 5 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut;
- se mungesa e një të drejte së detyrueshme për kompensim përbën shkelje të paragrafit 5 të nenit 5 Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut;
- Ombudspersoni konkludon se privimi i lirisë i vendosur me Urdhëresat Ekzekutive nuk është në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtare.

26. Lidhur me Rregullorën e UNMIK-ut 2001/18 mbi krijimin e Komisionit për shqyrtimin e paraburgimeve jashtëgjyqësore të bazuara në urdhëresat ekzekutive (25 gusht 2001), Ombudspersoni konkludon:

- që Komisioni për shqyrtimin e paraburgimit i paraparë sipas Rregullorës së UNMIK-ut 2001/18 mbi krijimin e Komisionit për shqyrtimin e paraburgimeve jashtëgjyqësore të bazuara në urdhëresat ekzekutive, nuk mund të konsiderohet gjykatë sipas paragrafit 4 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- që procedura e paraparë sipas Rregullorës së UNMIK-ut 2001/18 mbi krijimin e Komisionit për shqyrtimin e paraburgimeve jashtëgjyqësore të bazuara në urdhëresat ekzekutive nuk përmbush kërkesat e paragrafit 4 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

REKOMANDIMET

27. Ombudspersoni përserit rekomandimet e tij përmbajtësore dhe afatet e fundit të sugjeruara lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve të Raportit Special nr. 3, që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara:

- do të duhej që menjëherë të ndërprejë praktikën e lëshimit të Urdhëresave Ekzekutive apo çfarëdo formë tjetër të udhëzimeve, dekreteve apo vendimeve ekzekutive që vendosin privimin e lirisë mbi cilindo individ në Kosovë.
- do të duhej që, jo më vonë se më 20 korrik 2001, të themelojë një ose më tepër kolegje të përbërë nga gjykatësit ndërkombëtarë për të shqyrtuar, në baza urgjente, legjitimitetin e paraburgimit të individëve të cilët momentalisht janë të privuar nga liria në bazë të urdhëresave ekzekutive apo çfarëdo formë tjetër të udhëzimeve, dekreteve apo vendimeve ekzekutive, dhe që ky shqyrtim të jetë në pajtim me kërkesat e nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- do të duhej të marrë mbi vete të pajtohet me vendimet mbi paraburgim të vendosura nga ana e kolegjeve gjyqësore që janë themeluar në pajtim me këto rekomandime.
- do të duhej që, jo më vonë se më 31 gusht 2001, të shpallë një Rregullore që themelon bazën ligjore për kërkesat për kompenzimin për privimin e paligjshëm të lirisë dhe për procedurat e duhura gjyqësore lidhur me to.
- do të duhej që në datën e hyrjes së saj në fuqi, ta përhapë atë përmes të gjitha kanaleve të mundshme dhe në të gjitha gjuhët që përdoren në Kosovë, në pajtim me nenin 5.2. të Rregullores së UNMIK-ut 1999/01. Në veçanti, Rregullorja do të duhej të u shpërndahet të gjithë personave të cilët momentalisht janë të privuar nga liria në bazë urdhëresave ekzekutive të lëshuara nga PSSP-ja, dhe të gjithë gjykatësve, zyrtarëve të gjyqit ose të tjerëve të cilët ushtrojnë autoritetin gjyqësor në Kosovë;
- do të duhej që, jo më vonë se më 31 gusht 2001, ta informojë Ombudspersonin për veprimet e ndërmarra si përgjigje ndaj këtyre dy Rekomandimeve, në pajtim me nenin 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut 2000/38 mbi krijimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë.

28. Lidhur me Rregullorën e UNMIK-ut 2001/18 mbi krijimin e Komisionit për shqyrtimin e paraburgimeve jashtëgjyqësore të bazuara në Urdhëresat Ekzekutive (25 gusht 2001), Ombudspersoni konsideron se ajo nuk përben një përgjegje adekuate ndaj rekomandimeve të mësipërme.

Marek Antoni Nowicki
Ombudsperson